



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 6.11.2018

RAPORT

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT
TË MIRËKUPTIMIT, QË NDRYSHON MEMORANDUMIN
E MIRËKUPTIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE BASHKIMIT EVROPIAN, PËR PJESËMARRJEN
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E DREJTËSISË
TË BASHKIMIT EVROPIAN”**

- HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 6 nëntor 2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit, që ndryshon memorandumin e mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë të Bashkimit Evropian”. Komisioni caktoi si relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Elena Xhina. Komisioni e shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të paraqitur projektligjin, në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Brendshme.

- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji, nismë e Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, si dhe në nenin 18 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji ka si qëllim ndryshimin e Memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian (BE), për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë të Bashkimit Evropian, duke përfshirë edhe pjesën e katërt të komponentit “Politika e luftës kundër drogave”, të programit të drejtësisë së BE-së.

Nëpërmjet këtij memorandumi do të ofrohet asistencë për zbatimin e legjislacionit të BE-së në lidhje me: identifikimin dhe vlerësimin e substancave psikoaktive të reja, riintegrimin dhe rehabilitimin e përdoruesve të drogës, duke përfshirë edhe ata që kanë vuajtur dënimin në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, zhvillimin e metodologjive të përbashkëta të autoriteteve publike, në nivel lokal apo rajonal, dhe shoqërisë civile, me qëllim uljen e numrit të veprave penale të lidhura me drogën, shtimin e aktiviteteve të ndërgjegjësimit, përfshirjen e shoqërisë civile në zbatimin e objektivave të strategjisë dhe planit të veprimit të BE-së për drogën 2013-2020, me qëllim zvogëlimin e pasojave negative.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

-Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

-Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi me votat e shumicës së anëtarëve dhe vendosi t’ia kalojë për miratim seancës plenare.

RELATORE

Elena XHINA

KRYETARI

Ulsi MANJA